



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

Adresa: Nëna Terezë, Nr:20, 10000 Prishtinë – KOSOVË
Tel: +381 (0) 38 224 741, Tel&Fax: +381 (0) 38 224 299
info@oek-kcc.org, www.oek-kcc.org

Indikator matës i tendencës në biznes: Tremujori i dytë i vitit 2020

Tetor, 2020



Përmbajtja

- Përshkrim i shkurtër i indikatorit
- Metodologjia
- Gjetjet për klimën e biznesit në tremujorin e dytë të vitit 2020 dhe krahasimi me tremujorin e parë të vitit 2020.
- Përfundimet



Qëllimi

- Të ofroj informacion të besueshëm dhe në kohë për zhvillimet ciklike në ekonomi;
- Të ofroj informacione shtesë të rëndësishme të të dhënave statistikore kuantitative që publikohen me vonesë;
- Ofron mundësinë e vlerësimit të gjendjes së përgjithshme ekonomike si dhe identifikon ndryshime në ciklin e biznesit në kohë ose edhe paraprakisht; dhe
- Komisioni Evropian sugjeron realizimin e studimeve të harmonizuara për tendencën në biznes në të gjitha vendet anëtare.



- Indikatorë në më shumë se 100 shtete;
- I dizajnuar nga ekspertë gjermanë nga Instituti IFO në Gjermani;
- Përdoret nga qeveritë e shumë vendeve për marrjen e vendimeve dhe parashikimin e treguesve ekonomik;
- Vala e 30 e këtij indikatorit në Kosovë; dhe
- Të dhëna panel: të njëjtat firma të përcjella nëpër tremujor




METODOLOGJIA

- Mostra në tremujorin e dytë të vitit 2020 përbëhet prej 341 ndërmarrjeve
- Studimi përfshinë katër sektorë:
 - Tregti (shumicë dhe pakicë ndaras);
 - Prodhim (përpunimi i ushqimit; reciklimi; përpunimi i drurit, metaleve dhe materialit ndërtimor);
 - Ndërtimtari; dhe
 - Shërbime (transporti, shërbime profesionale dhe hoteleri)
- Mostra e nxjerrë nga databaza e Administratës Tatimore të Kosovës;
- Mostra e shpërndarë në tërë Kosovën dhe në tri grupe sipas madhësisë (0-9; 10-49; 50 e më shumë);
- Anketa e realizuar në muajin Gusht 2020

Gjetjet kryesore: Vlerësimi i situatës aktuale nga bizneset


Gjendja e biznesit në TM2 2020 është e pakënaqshme, përkatësisht rreth 80% e bizneseve kanë vlerësuar se kanë një gjendje jo të kënaqshme biznesore. Në krahasim me tremujorin paraprak gjendja në këtë tremujor është përkeqësuar akoma më shumë, përqindja e bizneseve që vlerësojnë situatën aktuale të pakënaqshme është më e madhe për 47 p.p.

Vlerësimi i situatës aktuale



Gjetjet kryesore: Vlerësimi i situatës aktuale nga bizneset: Balanca

Balanca tregon diferencën në mes të vlerësimit pozitiv dhe atij negativ. Në mënyrë të natyrshme siç pasqyrohet edhe tek gjendja aktuale, balanca paraqitet me një trend në rënie.




Gjetjet kryesore: Pritjet për punësim

Përderisa në TM e dytë të vitit 2019 35% e kompanive respondente prisnin rritje të numrit të punëtorëve, në TM e dytë të vitit 2020, janë vetëm rreth 7% që kanë pritje pozitive, pra kemi një rënie të pritshmërive prej 28 p.p.


Përqindja e kompanive që kanë pritshmëri negative për punësimin është rritur dukshëm në këtë TM në krahasim me TM paraprak, përkatësisht 25 p.p. Në shkallën e punësimit pritet të ketë rënie.

Pritjet për punësim



Gjetjet kryesore: Pritjet për punësim: Balanca


Në bazë të pritjeve të ulta për rritje të punësimit krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2019, edhe balanca është paraqitur me trend në rënie.



Gjetjet kryesore: Pritjet për 6 muajt e ardhshëm (% e bizneseve)

Ngjashëm sikur në indikatorët tjerë edhe pritjet për gjashtë (6) mujorë janë më pesimiste se në TM paraprak, kjo kryesisht për shkak të pritjeve të ulta të të gjithë sektorëve në vend. Rreth 38% e kompanive respondente kanë vlerësuar se situata e tyre biznesore në 6 muajt e ardhshëm do të përkeqësohet.

Pritjet për 6 muajt e ardhshëm




Balanca: situata aktuale; klima biznesore dhe pritjet për 6 muajt e ardhshëm

Indikatori për klimën e biznesit si matës i aktivitetit ekonomik në një vend është mesatarja aritmetike e vlerësimit të situatës aktuale dhe pritjeve për biznes për gjashtë muajt e ardhshëm, pra është kombinim i pritjeve me vlerësimin e situatës aktuale.

Klima e biznesit në vend është përkeqësuar për 37 p.p krahasuar me TM1 2020.


Balanca: situata aktuale; klima biznesore dhe pritjet për 6 muajt e ardhshëm




Indikatori i konfidencës/besueshmërisë

- Përderisa, treguesi i klimës së biznesit fokusohet në situatën e fitimit të ndërmarrjeve (aktual dhe i pritshëm), indikatori i konfidencës (treguesi i besimit) vë theks më shumë në aktivitetin e biznesit (aktual dhe të pritshëm) pa marrë parasysh se sa fitimprurës është. Treguesi i besimit është përdorur gjerësisht në analizën ekonomike të Komisionit Evropian dhe është në dispozicion për të gjitha vendet anëtare të BE.
- ***Indikatori i konfidencës poashtu ka shënuar rënie të madhe në krahasim me TM paraprak (rreth 37.3 p.p).*** Konfidenca në rënie kryesisht u ndikua nga deklaratimet negative të sektorëve kyq ekonomik në vend. **Indikatori i konfidencës në këtë tremujor është -44.7, dhe njëherit dhe vlera më negative e shënuar ndonjëherë që nga vitit 2013 kur ka filluar të realizohet ky indikator.**

Indikatori i konfidencës/besueshmërisë (vazhdim)



Barrierat e bizneseve





PËRFUNDIMET

Gjendja e biznesit në TM2 2020 është e pakënaqshme, përkatësisht rreth 80% e bizneseve kanë vlerësuar se kanë një gjendje jo të kënaqshme biznesore. Në krahasim me tremujorin paraprak gjendja në këtë tremujor është përkeqësuar akoma më shumë, përqindja e bizneseve që vlerësojnë situatën aktuale të pakënaqshme është më e madhe për 47 p.p.

Përqindja e kompanive që kanë pritshmëri negative për punësimin është rritur dukshëm në këtë TM në krahasim me TM paraprak, përkatësisht 25 p.p. Në shkallën e punësimit pritet të ketë rënie.

Ngjashëm sikur në indikatorët tjerë edhe pritjet për gjashtë (6) mujorë janë më pesimiste se në TM paraprak, kjo kryesisht për shkak të pritjeve të ulta të të gjithë sektorëve në vend. Rreth 38% e kompanive respondente kanë vlerësuar se situata e tyre biznesore në 6 muajt e ardhshëm do të përkeqësohet.

Indikatori i konfidencës ka shënuar rënie të madhe në krahasim me TM paraprak (rreth 37.3 p.p). Konfidenca në rënie kryesisht u ndikua nga deklaratimet negative të sektorëve kyç ekonomik në vend. ***Indikatori i konfidencës në këtë tremujor është -44.7, dhe njëherit dhe vlera më negative e shënuar ndonjëherë që nga vitit 2013 kur ka filluar të realizohet ky indikator.***

Mungesa e porosive është vlerësuar si një ndër barrierat kryesore gjatë të bërit biznes në TM2 2020, për rreth 58% të kompanive pjesëmarrëse në studim, pasuar nga normat e larta të interest (54%) dhe mungesa e mjeteve financiare (47%).



ODA EKONOMIKE | KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS | OF COMMERCE

Adresa: Nëna Terezë, Nr:20, 10000 Prishtinë – KOSOVË
Tel: +381 (0) 38 224 741, Tel&Fax: +381 (0) 38 224 299
info@oek-kcc.org, www.oek-kcc.org

Falemnderit!

Departamenti për Analiza Ekonomike dhe Politika
Oda Ekonomike e Kosovës
Nëna Terezë, Nr.20
10 000 Prishtinë
Republika e Kosovës

Tel: [+383 \(0\) 38 224 299](tel:+383224299)
Fax: [+383 \(0\) 38 224 299](tel:+383224299)
Email: info@oek-kcc.org
web: www.oek-kcc.org